




SELDI.net

Southeast European Leadership for
Development and Integrity







VLERËSIMI



I KORRUPSIONIT

NË KOSOVË

2016





VLERËSIMI

I KËRRUPSIONIT

NË KOSOVË

2016

Financuar nga:
Bashkimi Evropian



Deklaratë mohimi:

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Komisionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Institutit Riinvest dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Komisionit Evropian.

Kontribuuesit:

Enisa Serhati, Fatos Hoxha,
Alban Hashani, Lumir Abdixhiku,
Gent Beqiri dhe Alban Zogaj

Dizajni dhe Faqosja:

Faton Selani

Mirënjohje:

Ky raport është përgatitur në bashkëpunim të afërt me partnerët e SELDI-t dhe ndjekë metodologjinë kërkimore të zhvilluar nga rrjeti SELDI.

Originali është shkruar në shqip

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org




E drejta autoriale © 2016 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

SHKURTESAT

| | | |
|----------------|---|---|
| AKK | → | Agjencia Kundër Korrupsion |
| BIRN | → | Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese i Kosovës |
| OSC | → | Organizata e Shoqërisë Civile |
| KE | → | Komisioni Evropian |
| BE | → | Bashkimi Evropian |
| EULEX | → | Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë |
| GRECO | → | Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit |
| KDI | → | Instituti Demokratik i Kosovës |
| OJQ | → | Organizata jo-qeveritare |
| ZAP | → | Zyra e Auditorit të Përgjithshëm |
| ZKD/ZPD | → | Zyra e Këshillit / Prokurorit Disiplinor |
| ZPSh | → | Zyra e Prokurorit të Shtetit |
| KRPP | → | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik |
| UNDP | → | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNCAC | → | Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit |


TABELA E PË

| | |
|--|-----------|
| Shkurtesat | 5 |
| Parathënie | 8 |
| Hyrja | 9 |
| Metodologjia | 10 |
| Kapitulli 1 | 12 |
| Përvoja me korrupsionin..... | 12 |
| Qëndrimet ndaj korrupsionit..... | 15 |
| Vlerësimi i mjedisit të korrupsionit | 18 |



ERMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| Kapitulli 2 | 22 |
| Rishikim i zhvillimeve të fundit të korrupsionit dhe anti-korrupsionit në Kosovë | 22 |
| Korniza ligjore dhe institucionet anti-korrupsion | 22 |
| Politikat Anti-korrupsion dhe Mjedisi Rregullativ..... | 22 |
| Strategjia e re Anti-Korrupsion dhe Plani i Veprimit | 23 |
| Organet e tjera që kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit..... | 24 |
| Zbatimi i Ligjit dhe Praktikrat Institucionale | 25 |
| Korrupsioni dhe Ekonomia..... | 26 |
| Prokurimi Publik dhe Korrupsioni..... | 27 |
| Shoqëria Civile, Media dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Anti-Korrupsion | 28 |
| Shqyrtimi i punës së Shoqërisë Civile kundër korrupsionit..... | 28 |
| Bashkëpunimi Ndërkombëtar | 29 |
| Rishikim i rekomandimeve nga Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit në Kosovë, 2014..... | 30 |
| Përmbyllja | 31 |
| Rekomandimet | 32 |
| Referencat | 33 |



Parathënie

Korrupsioni është një fenomen global. Në një shtet të caktuar, ai mund të marrë forma dhe dimensione të ndryshme, në varësi të kushteve socio-ekonomike apo natyrës së institucioneve të tij. Korrupsioni është përhapur me shpejtësi të madhe në vendet në zhvillim, duke goditur rëndë veçanërisht ato të cilat përqipen të bëjnë kalimin nga një ekonomi e centralizuar në ekonomi të tregut, ose ato të dalin nga konfliktet e dhunshme. Kosova është një shembull i tillë. E shtrirë në një rajon ku proceset demokratike dhe krijimi i një shoqërie me institucione transparente dhe të përgjegjshme janë duke u penguar nga fenomeni, Kosova ka provuar në mënyrë të vazhdueshme, kryesisht pa sukses, të fus korrupsionin nën kontroll.

Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të njohurive, e cila do të facilitojë zbatimin e masave adekuata të politikave anti-korrupsion (dhe jo arbitrare), ky raport është një vlerësim i thellë mbi korrupsionin dhe anti-korrupsionin në Kosovë. Dy pjesët kryesore të këtij studimi janë (1) diskutimi i gjetjeve nga hulumtimi parësor, dhe (2) shqyrtimi i zhvillimeve politike dhe institucionale ndaj (anti) korrupsionit në Kosovë.

Rezultatet e anketës tregojnë një gjendje veçanërisht shqetësuese në lidhje me perceptimin publik të korrupsionit në Kosovë, duke treguar se shumica e njerëzve konsiderojnë se shumë sektorë të shoqërisë dhe segmente të qeverisë janë të njohur me korrupsion.

Ky raport hulumtues nxjerrë të dhëna të vlefshme të cilat mund të shfrytëzohen nga një gamë e gjerë e akterëve, duke përfshirë, më me rëndësi, institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive për luftimin e korrupsionit. Konkluzionet e paraqitura më tutje fokusohen në ngritjen e vetëdijesimit të këtyre institucioneve dhe shoqërisë në tërësi për perceptimin e korrupsionit në Kosovë, si dhe nevojën për ta luftuar të gjithë së bashku.

Situata e korrupsionit në Kosovë është shumë e ngjashme me atë të fqinjëve të saj më rajon. Fenomeni dëshmon të jetë një pengesë serioze për avancimin e proceseve demokratike dhe krijimin e një shoqërie me institucione funksionale, transparente dhe llogaridhënëse. Kjo fotografi shqetësuese është konfirmuar nga rezultatet e anketës. Rezultatet sugjerojnë se Kosovarët e kuptojnë qartë se çfarë përbën korrupsioni, ata janë bërë më të ndjeshëm ndaj rasteve të korrupsionit dhe, me disa përjashtime të vogla, niveli

i tyre i të kuptuarit të kësaj çështje është rritur që nga anketa paraprake e kryer në vitin 2014.

Rekomandimi kryesor i cili rrjedh nga ky raport është nevoja urgjente për angazhimin me prioritet të luftës kundër korrupsionit nga të gjithë akterët relevantë. Nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse, e cila do të zbatohet dhe jo vetëm të hartohet për të përmbushur kërkesë për integrimin në BE, është me rëndësi të madhe.

Hyrja

Të kuptuarit e ndryshimit të dinamikës së korrupsionit dhe sigurimit të informacionit të besueshëm në lidhje me të janë pjesë qendrore të një lufte të suksesshme kundër korrupsionit. Historikisht, fenomeni i korrupsionit ka qenë vështirë i menaxhueshëm, dhe domosdoshmëria e akterëve të ndryshëm të shoqërisë për të kontribuar në një luftë të përbashkët mbetet jetike. Shoqëria civile, duke qenë një prej këtyre akterëve, është një forcë e fuqishme në ngritjen e vetëdijes publike, në nxitjen e reformave të politikave, dhe në angazhimin e Qeverisë në një mision të serioz kundër korrupsionit.

Korrupsioni nuk është çështje e re për Kosovën. Vëzhgimi i mjedisit korruptiv dhe zhvillimi i politikave kundër korrupsionit mbeten betejë e vazhdueshme për sundimin e ligjit në vendin e ri. Perspektiva e largët e anëtarësimit në Bashkimin Evropian i jep Kosovës një kornizë për të ndjekur, megjithatë akterët lokalë janë përgjegjës për luftimin e këtij fenomeni dhe krijimin e një gjendje optimiste për zhvillim.

Me qëllim të ngritjes së mëtutjeshme të njohurive, e cila do të facilitojë zbatimin e masave adekuate të politikave anti-korrupsion (dhe jo arbitrar), ky raport është një vlerësim i thellë mbi korrupsionin dhe anti-korrupsionin në Kosovë.

Dy pjesët kryesore të këtij studimi janë (1) diskutimi i gjetjeve nga hulumtimi parësor, dhe (2) shqyrtimi i zhvillimeve politike dhe institucionale ndaj (anti) korrupsionit në Kosovë.

Si rezultat i punës së Institutit Riinvest në kuadër të LiderShipit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI), ky është raporti i dytë i Vlerësimit të Korrupsionit nga Kosova i cili përdorë Sistemin e Monitorimit të Korrupsionit (SMK) si strategji primare kërkimore për të vlerësuar korrupsionin.

SMK është një metodologji hulumtimi lidhur me korrupsionin zhvilluar nga SELDI, të cilën e ka lansuar në vitin 2000, në një kohë kur vlerësimi i korrupsionit ishte i limituar në matjen e perceptimit publik. Kontribut i rëndësishëm i SMK është futja e masave që vlerësojnë përvojat e drejtpërdrejta të qytetarëve me praktikën korruptive.

Pjesa e dytë e studimit diskuton zhvillimet institucionale, legjislativ dhe politike në Kosovë, me fokus të veçantë në rezultatet e arritura. Siç do të shihet në këtë seksion,

progresi i pamjaftueshëm i sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe mungesa e personelit të trajnuar dhe të kualifikuar; progresi relativ i reformave në prokurimin publik; dhe funksionimi i kufizuar institucional, kanë rezultuar në një rishikim të problemeve të njëjta të trajtuara nga Raporti i parë i vlerësimit të korrupsionit në shtet (Riinvest 2014). Pra, me këtë rast raporti shqyrton po ashtu nivelin në të cilin janë zbatuar rekomandimet e Raportit të parë të vlerësimit të korrupsionit në Kosovë.

Studimi është i organizuar si më tej: seksioni i parë paraqet (1) metodologjinë e përdorur të hulumtimit dhe shpjegon strukturën e indekseve të vlerësimit të korrupsionit të krijuara. Pjesa e dytë përmbledh (2) rezultatet e anketës, të ndara në tri kategori kryesore: Eksperienca me korrupsionin, Qëndrimet ndaj korrupsionit dhe Perceptimet Publike. Kapitulli i dytë kryesor i studimit diskuton për zhvillimet e fundit të korrupsionit dhe anti-korrupsionit në Kosovë përmes katër seksioneve të cilat diskutojnë (3) Politikën anti-korrupsion dhe mjedisin rregullator, (4) strategjinë e re anti-korrupsion dhe planin e veprimit, (5) institucionet kombëtare që kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit, dhe në fund (6) praktikën e zbatimit të ligjit dhe ato institucionale. Në fund, raporti jep një (7) Përfundim që i referohet një përmbledhje të gjetjeve dhe ofron (8) rekomandime në përputhje me rrethanat.


Metodologjia

Ky raport është i bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore përfshijnë anketën e qytetarëve të rritur të Kosovës, e cila është kryer në periudhën shkurt-mars 2016. Mostra mbulon përgjigjet nga 1000 të anketuar, të mbledhura në mënyrë të rastësishme në tërë Kosovën, duke ndjekur metodologjinë e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit (SMK). SMK vlerëson korrupsionin, përtej praktikës së zakonshme për të vlerësuar perceptimet publike, duke përdorur masat që përshijnë përvojat e drejtpërdrejta të individëve me zyrtarët e korruptuar. SMK është një strategji që është përdorur nga të gjithë partnerët e SELDI dhe ofron krahasueshmëri të të dhënave nëpër shtete duke përcjellë nivelin e korrupsionit, qëndrimet publike, vlerësimet dhe

pritjet nga viti 2002. Indekset e korrupsionit janë treguesit më të rëndësishëm që nxjerrën si rezultat i anketave dhe përmbledhin tri grupe të koncepteve:

- Përvojën,
- Qëndrimet dhe
- Perceptimet

FIG. 01 Struktura e indekseve të Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit



Indekset SMK, të zbërthyer në Figurën 1, matin korrupsionin administrativ, që për qëllimet e këtij studimi është përcaktuar si "ofrimi i përfitimeve (të holla, dhurata dhe favore), nga ana e qytetarëve në këmbim të shërbimeve që ata marrin nga zyrtarët publikë" (SELDI, 2014). Secili prej indekseve kryesore të SMK përbëhet nga nën-indekset që shpjegohen më poshtë.

● Indekset e korrupsionit të bazuar në përvojë janë të ndarë në dy indekseve:

- *Presioni për Korrupsion* i cili pasqyron rastet e qytetarëve nga të cilët direkt ose indirekt është kërkuar një pagesë jo formale. Kryesisht, rezultatet tregojnë se presioni është një faktor vendimtar për përfshirjen në korrupsion.
- *Përfshirja në Korrupsion* e cila vlerëson rastet kur qytetarët i paguajnë zyrtarët publikë në mënyrë jo formale. Pyetjet e përdorura në gjenerimin e këtij indikatori cilësohen si pyetje viktimizimit dhe përgjigje të ndara në dy kategori: njerëz të cilët nuk kanë pasur përvojë me korrupsionin administrativ (nuk kanë bërë ndonjë pagesë jo formale), dhe ata që kanë pasur të paktën një përvojë të tillë.

● **Indekset e korrupsionit të bazuara në qëndrime** shprehin atmosferën e përgjithshme politike dhe sociale në vend, ndërkohë që në një mase këto indekse pritet të lidhen për përfshirje në korrupsion (qëndrimet pozitive ndaj sjelljes korruptive do të lidhen me nivele më të larta të përfshirjes në korrupsion). Indikatorët e qëndrimeve ndaj korrupsionit të përdorura në SMK:

- *Ndërgjegjësimi (Identifikimi i Korrupsionit)* reflekton nivelin e të kuptuarit nga ana e qytetarëve të asaj që e bën një sjellje korruptive – ose komponentën e njohurive. Ekzistojnë tri nivele të ndërgjegjësimit: i lartë (të gjitha sjelljet korruptive janë identifikuar), i moderuar (shumica e praktikave korruptive janë identifikuar), dhe i ulët (disa modele korrupsioni janë identifikuar).
- *Pranueshmëria e Sjelljeve Korruptive* tregon tolerancën ndaj korrupsionit. Kjo vlerëson pranueshmërinë e të pasurit zyrtarët publikë të cilët marrin një lloj shpërblimi në këmbim të shërbimit të tyre.
- *Ndjeshmëria ndaj korrupsionit* reflekton tendencën e të anketuarve për të reaguar ndaj dy situatave hipotetike – një që përfshin rolin e zyrtarëve publikë për të pranuar apo mohuar ryshfetin e ofruar, dhe situata e dytë e cila pyet nëse ryshfeti është alternativë nëse dikush ka një problem të madh për të zgjidhur.

FIG. 02 Ndërveprimi në mes të indekseve



● **Perceptimet** ndaj korrupsionit tregojnë nivelin e përgjithshëm të besimit dhe opinionit ndaj korrupsionit në shoqëri. Ky dimension është i ndarë në tre tregues.

- Gjasat e Presionit të Korrupsionit që mat pritjet e qytetarëve në lidhje me mundësinë e përbaljes me presionin e korrupsionit nga ana e zyrtarëve publikë.
- Gjasat e Korruptimit të Zyrtarëve Publik përfshijnë reputacionin e integritetit të grupeve të ndryshme të zyrtarëve publikë. Pra, ky tregues jep një vlerësim të qëndrimeve të qytetarëve ndaj zyrtarëve publikë dhe tregon sektorët më të prekur nga korrupsioni.
- Fizibilitetit i Reagimit të Politikave vlerëson besimin potencial të publikut në luftën e qeverisë kundër korrupsionit, si dhe mbështetjen e publikut për politikën anti-korrupsion.

Ndërveprimi në mes të indekseve të korrupsionit në strategjinë SMK është paraqitur në figurën 2. Në këtë paraqitje grafike, perceptimet ndaj korrupsionit dhe indeksi i bazuar në përvojë me korrupsionin lëvizin në të njëjtin drejtim, duke qenë që ndryshimet në perceptimet janë shkaktuar nga ndryshimet në përvoja me korrupsionin. Indekset e korrupsionit të bazuara në qëndrime, në anën tjetër, lëvizin në drejtim të kundërt me perceptimet ndaj korrupsionit – duke demonstruar kështu një pranueshmëri më të ulët të korrupsionit me më shumë perceptime negative të korrupsionit dhe përvojës më të madhe me korrupsion.

1

Përvoja me korrupsionin

Në rezultatet e SMK-së, **përvoja** e qytetarëve me korrupsionin vërehet në dy kategori të indekseve: indekset e ndërlidhura me (1) **presionin nga korrupsioni** dhe (2) indekset e ndërlidhura me **përfshirjen në korrupsion**. Kategoria e fundit gjeneron indekse që reflektojnë se sa shpesh qytetarët janë pyetur në mënyrë të drejtpërdrejt nga zyrtarët publikë të paguajnë ryshfet. Rastet e tilla janë të referuara në këtë studim si viktimizim nga presioni për korrupsion. Lloji i dytë i indekseve vlerëson përfshirjen në raste konkrete të korrupsionit dhe merr në konsideratë tri lloje të ryshfetit, duke përfshirë 'Dhënien e parave një zyrtari', 'Kryerjen e favoreve për një zyrtar', dhe 'Dhënien e një dhurate për një zyrtar'.

Presioni nga korrupsioni dhe **përfshirja** në korrupsion janë indekse të analizuar së bashku në këtë model brenda konceptit të **përvojës** me korrupsionin, sepse të dhënat rajonale të SMK-it të SELDI-it kanë treguar se presioni është një faktor me rëndësi jetike që dërgon në përfshirje në aktivitete korruptive. Në shumicën e rasteve, transaksionet e korrupsionit ndodhin pasi që zyrtarët e korruptuar fillojnë aktin duke kërkuar ryshfet. Këto indekse të veçanta tregojnë nivelet e korrupsionit për vitin paraprak (anketa është zbatuar në vitin 2016), pasi që të anketuarit janë pyetur për përvojat e tyre në vitin e kaluar.


Figura 3 tregon se në Kosovë normat e përvojës me korrupsionin për vitin paraprak (2015) janë të larta. Pothuajse dy të tretat (27 për qind) e popullsisë pretendojnë se atyre u është kërkuar ryshfet, dhe mbi një e pesta (22 për qind) thonë se kanë dhënë ryshfet. Të njëjtat indekse, në rezultatet e SMK-it

të bërë në vitin 2014 kanë arritur shifra pak më të ulëta (23 për qind presion dhe 20 për qind përfshirje).

Është e qartë nga këto të dhëna se korrupsioni është një karakteristikë sistematike e institucioneve publike në vend, edhe pse, për shkak të mungesës së serive kohore më të gjata të SMK-së, nuk mund të konkludohet se përvoja me korrupsionin administrativ në Kosovë ka një tendencë në rritje.

FIG. 03 Presioni nga korrupsioni dhe përfshirja në korrupsion


(% e popullatës 18+ të cilëve u është kërkuar për të dhënë dhe kanë dhënë ryshfet (para, nder, dhuratë) në vitin e kaluar)



BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

FIG. 04 Presioni i qartë dhe i nënkuptuar për korrupsion

(%e popullatës 18+ të cilëve në vitin paraprak u është kërkuar në formë direkte dhe indirekte të japin ryshfet)




BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2016

Presioni nga korrupsioni mund të marrë një formë të qartë ose të nënkuptuar, në varësi të faktit nëse dhënia e ryshfetit ka qenë një kërkesë e drejtpërdrejtë nga zyrtarët publikë, ose nëse kërkesa për ryshfet është lënë për t'u nënkuptuar. Figura 4 tregon se në Kosovë, presioni për ryshfet ka ndodhur në formë direkte dhe indirekte, duke treguar se nxitja e korrupsionit nuk është një dukuri e jashtëzakonshme në funksionimin e administratës publike.

Figura 5 tregon se përfshirja në korrupsion është një përcaktues jetik i transaksioneve korruptive dhe shumica e atyre që kanë paguar ryshfet kanë qenë nën presion për të bërë

FIG. 05 Përfshirja në korrupsion me ose pa presion për korrupsion- Kosovë

(% e popullatës 18+, të cilët kanë dhënë ryshfet me ose pa presion për korrupsion)




BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

një gjë të tillë. Shoqëritë me presion të lartë dhe përfshirje të lartë në korrupsion karakterizohen me qëndrueshmëri të ulët ndaj korrupsionit. Në kthim, ryshfeti bëhet një mënyrë për të lehtësuar rrugën drejt shërbimeve publike.

Përvoja e qytetarëve të Kosovës me lloje të ndryshme të ryshfetit tregohet në figurën 6. Brenda tri llojeve të ryshfetit të vlerësuar, përqindja e popullatës kosovare e cila ka dhënë të holla, dhurata, ose favore është 14, 13, dhe 13 përqind, respektivisht. Mesatarisht, këto rezultate janë 3 pikë përqindje më të ulëta se ato të SMK-së 2014.

FIG. 06 Përfshirja në korrupsion dhe llojet e rryshfetit

(% e popullatës të cilët në vitin paraprak kanë dhënë të holla, dhuratata, ose favore për një zyrtar publik)




Një krahasim mes vendeve të cilat janë partnere të SELDIT sa i përket përvojës me korrupsion, tregon se korrupsioni administrativ në Kosovë është në një nivel të krahasueshëm me rajonin. Figura 7 ilustron përfshirjen në korrupsion për të gjithë partnerët e SELD-it dhe vendos nivelin e korrupsionit në Kosovë midis Bullgarisë dhe Malit të Zi, në një pikë mesatare të listës së përgjithshme. Renditja është bërë në bazë të përqindjes së popullsisë që është përfshirë në praktika korruptive, ndërsa nëse vendet do të renditeshin në bazë të presionit për korrupsion, Kosova do të renditej një pozitë më lartë.

Figura 7 tregon se Shqipëria renditet më së larti nga vendet e tjera në të dy indekset e përvojës me korrupsion. Shqipëria ka pjesën më të madhe të popullsisë që është përfshirë në korrupsion ose që kanë përjetuar presion për korrupsion. Ndërsa, në anën tjetër të rangimit qëndrojnë Turqia dhe Kroacia, dy vende që kanë përqindjen më të ulët të nivelit të korrupsionit të raportuar për SMK 2016 dhe 2014.

Në seksionin **Përvoja me korrupsionin**, të dy indekset kryesore të diskutuar (përfshirja në korrupsion dhe presioni për korrupsion) kanë treguar një pjesë të madhe të popullsisë të prekur nga korrupsioni. Gjetjet, më tej, theksojnë se presioni është një përcaktues vital i transaksioneve korruptive (**përfshirjen**), dhe se në shumicën e rasteve, rryshfetet janë dhënë si përgjigje në aktin e filluar nga ana e zyrtarëve publikë të korruptuar.

FIG. 07 Presioni për korrupsion dhe përfshirja në korrupsion në regjion


% e popullatës 18+ të cilëve në vitin e kaluar u është kërkuar rryshet dhe kanë dhënë rryshfet (para, dhuratata, favore)



Qëndrimet ndaj korrupsionit

FIG. 08 Acceptability of corruption

(% of the population 18+, who accept or do not accept different forms of corrupt behaviour)




Qëndrimet zbulojnë opinion e shoqërisë sa i përket fenomenit të korrupsionit. Bindjet e njerëzve në SMT janë nxjerr përmes tri indekseve të qëndrimeve: (1) **pranueshmëria** - indeks i cili mat se sa i pranueshëm është korrupsioni për qytetarët, (2) **vetëdijesimi**- indeks i cili pasqyron shkallën në të cilën aktivitetet korruptive konsiderohen si shkelje ligjore , dhe (3) **ndjeshmëria** sa i përket korrupsionit – indeks i cili paraqet integritetin e qytetarëve, ose gjasat e tyre për të dhënë ose pranuar rryshfet.

Figura 8 tregon se në Kosovë gati një në dy qytetarë do të pranonte ndonjë lloj të praktikës korruptive, duke konfirmuar në këtë mënyrë një nivel të lartë të tolerancës ndaj korrupsionit administrativ. Për më tepër, shkalla në të cilën korrupsioni është rrënjësuar në sistem demonstron më tej nga rritja 6 për qind e pranueshmërisë së korrupsionit nga viti 2014 në vitin 2016.

Një krahasim mes vendeve tregon se pranueshmëria e korrupsionit në Kosovë është e lartë në krahasim me pranueshmërinë e korrupsionit në vendet e tjera të Evropës Juglindore. Të renditura në bazë të përqindjes së popullsisë që pranojnë forma të ndryshme të korrupsionit në mesin e vendeve partnere të SELDI-it, Kosova renditet si vendi i dytë me popullsinë më tolerante ndaj korrupsionit, me vetëm Shqipërinë e cila rendit një pozitë më lartë (Figura 9). Ky dimension ngre shqetësime lidhur me përgjegjësinë sociale të Kosovës në çështjen e korrupsionit, si dhe vetëdijes qytet-

FIG. 09 Krahasim mes vendeve lidhur me pranueshmërinë e korrupsionit

(% e popullatës 18+ të cilët pranojnë forma të ndryshme të praktikave korruptive)



are lidhur me pasojat që mund t'i ketë një administratë e korruptuar në zhvillimin e vendit.

Vetëdijesimi ndaj korrupsionit, indeksi i dytë në kuadër të konceptit të **qëndrimeve**, paraqet një tregues të rëndësishëm në vlerësimin e fenomenit të korrupsionit. Edhe pse vetëdijesimi nuk është i lidhur direkt me nivelin e korrupsionit në vend, ai tregon shkallën në të cilën korrupsioni është një temë e debatit shoqëror dhe se sa e dukshme është lufta kundër tij në vend.

Të anketuarit janë pyetur për të vlerësuar nëse veprimet e renditura në Tabelën 1 janë shembuj të korrupsionit. Përgjigjet tregojnë se , në përgjithësi , ka një përmirësim në identifikimi e aktiviteteve korruptive nga viti 2014 në vitin 2016.

Tabela 1 paraqet vetëdijesimin e të anketuarve lidhur me aktivitetet të cilat ata i konsiderojnë si korruptive. Përmirësimet e vogla në aftësinë për të identifikuar aktivitetet korruptive nga anketa e viti 2014 me atë në vitin 2016 janë

TAB. 01 Vetëdijesimi lidhur me praktikat e zakonshme korruptive


Sipas mendimit tuaj, cila nga veprimet e mëposhtme janë shembuj të “korrupsionit”?

| | 2014 | 2016 |
|--|-------|-------|
| Dhënia e një dhurate mjekut në mënyrë që ai/ajo të kujdeset në mënyrë të veçantë për ju | 70.8% | 76.6% |
| Dhënia e parave / bërja e një favorit një zyrtari administrativ në mënyrë që të fitoj një konkurs, koncesion apo tender publik | 79.9% | 95.2% |
| Shfrytëzimi i “lidhjeve” për të marr një shërbim të caktuar publik në të cilin ju keni të drejt me ligj | 72.8% | 53.4% |
| Lobimi tek një zyrtar publik për të punësuar një të afërm (familjar, mik) tuaj | 76.6% | 77.3% |
| Kontraktimi i një këshilltari komunal personalisht, më mënyrë që të merret leja për ndërtim | 70.6% | 76.1% |
| Dhënia e parave ndonjë polici në mënyrë që leja e vozitjes të mos pezullohet | 75.5% | 93.9% |
| Shfrytëzimi i pozitës zyrtare për bërjen e bizneseve private | 73.9% | 83.0% |
| Dhënia e informatave konfidenciale të marra në zyre publike ndonjë të afërmi për përfitime personale | 73.2% | 75.2% |
| Pranimi i parave nga zyrtarët administrativ për të lejuar evazionin fiskal apo reduktimin e taksave. | 76.3% | 79.5% |
| Dhënia e donacioneve paraelektorale partive politike | 67.7% | 66.1% |
| Ofrimi i kompensimit shtesë për avokatit i cili ndihmon një të pandehur në ndalimin e padisë kundër atij/asaj | 70.1% | 71.6% |

BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

FIG. 10 Vetëdijesimi (identifikimi) ndaj praktikave të zakonshme korruptive

(% e popullsisë 18+ e cila identifikon praktika të zakonshme korruptive - të gjitha (i lartë), shumicën (i moderuar) dhe disa (i ulët)



BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

shënuar në ngjyrë blu. Sa ma e errët ngjyra blu aq më i madh është përmirësimi. Nga ana tjetër, ngjyra e kuqe tregon aktivitetet të cilat janë identifikuar si korruptive nga më shumë të anketuar në anketën e vitit 2014 se sa në atë të vitit 2016.


Forma më të buta të korrupsionit si (1) ‘Shfrytëzimi i “lidhjeve” për të marr një shërbim të caktuar publik për të cilin qytetarët kanë të drejtë (me ligj)’ dhe (2) ‘Dhënia e donacioneve parazgjedhore tek partitë politike’ janë veprime të cilat njihen më së paku si korruptive. Rastet më konkrete të korrupsionit, nga ana tjetër, konsiderohen (1) ‘Dhënia e parave / bërja e një favorit për një zyrtar të administratës në mënyrë që të fitojë një konkurs, koncesion ose tender publik’ dhe (2) ‘ Dhënia e parave një oficeri të policisë në mënyrë që patenta e vozitjes të mos pezullohet’.

Pra, në Kosovë, niveli i vetëdijesimit ndaj korrupsionit është rritur në dy vitet e fundit. Rritja është shënuar me një reduktim të ndjeshëm në pjesën e popullsisë së rritur që ka një nivel të ulët të vetëdijesimit (Figura 10).

Sipas SMK 2016, përqindja e popullsisë së identifikuar gjatë vitit 2014 me vetëdijesim të ulët është zhdukur pothuajse. Megjithatë, një e treta e popullsisë ka vetëm një nivel të moderuar të vetëdijesimit. Dhe së fundi, një tregues i faktit se ka shumë vend për përmirësim në nivelin e vetëdijesimit për korrupsionin është fakti se Kosova ka nivelin më të ulët të vetëdijesimit nga të gjitha vendet e SELDI-it. Në Bosnje dhe Hercegovinë, për shembull, 86 për qind e popullsisë kanë nivelin e lartë të vetëdijesimit, figurë 20 për qind më e lartë se në Kosovë.

FIG. 11 Ndjeshmëria ndaj korrupsionit

(% e popullsisë 18+ të cilët do të jepnin dhe/ose pranonin rryshfet në rolin e qytetarit dhe/ose zyrtarit)



Ndjeshmëria ndaj korrupsionit është indeksi i tretë i vlerësuar në kategorinë e **qëndrimeve** ndaj korrupsionit. Ky indeks tregon predispozitën e qytetarëve për t'u angazhuar në sjellje administrative të korrupsionit. Vendet me ndjeshmëri të ulët janë konsideruar të kenë nivele më të larta të integritetit dhe rezistencë më të lartë ndaj presionit për korrupsion.

Në anketën e SMK 2016, qytetarët u pyetën nëse ata do të pranonin të jepnin para, dhurata ose bëjnë favore në qoftë se ata vet do të ishin në një pozitë me pagë të ulët, ose në qoftë se ata kishin një problem të madh për të zgjidhur. Sipas rezultateve, 38 për qind e popullsisë së rritur janë të ndjeshëm ndaj korrupsionit (një rënie e lehtë nga viti 2014), dhe 31 për qind ishin të pasigurt në sjelljet e tyre pasi që vendimet e tyre do të vareshin nga rezultatet që ata presin dhe konteksti i çështjes. Përgjigjet e 31 për qind e fundit të popullsisë treguan se ata nuk ishin aspak të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe se ata nuk do të përdornin praktikatat korruptive në asnjë mënyrë.

Vlerësimi i qëndrimeve ndaj korrupsionit drejton tek zhvillimet në drejtime të ndryshme. Para së gjithash, analiza e pranueshmërisë tregon se ka pasur një rritje në nivelin e pranueshmërisë së korrupsionit në shoqërinë kosovare. Kthimi i korrupsionit në 'praktikë të zakonshme' ka vendosur Kosovën në majë të renditjes në mes të vendeve anëtare në SELDI sa i përket perceptimit ndaj korrupsionit.

Në të njëjtën kohë, vetëdijesimi i qytetarëve me atë që përkon me sjellje korruptive është në nivel të ulët në krahasim me rajonin, edhe pse vetëdijesimi është rritur nga viti 2014. Në mënyrë të ngjashme, indeksi i ndjeshmërisë

ndaj korrupsionit tregon se edhe pse përqindja e atyre që dëshirojnë të angazhohen në korrupsion, në mënyrë për të zgjidhur një problem të madh, ka rënë nga 2014 në 2016, problemi mbetet i një rëndësie të madhe.


Vlerësimi i mjedisit të korrupsionit

Vlerësimi i **mjedisit të korrupsionit** tregon perceptimet e qytetarëve rreth mendimit politik dhe besimit të tyre në praktikën qeveritare. Perceptimet e korrupsionit zakonisht janë shumë më negative se sa përhapja aktuale e praktikave korruptive, dhe si të tilla nuk janë matësi kryesor i nivelit të korrupsionit në vend. Mirëpo, perceptimet akoma përdoren tradicionalisht si indikatorë për vlerësimin e mjedisit të korrupsionit në nivel ndërkombëtar.

Pritjet rreth përjetimit të ndonjë forme të presionit të lartë korruptiv, për popullatën e Kosovës janë të larta. 73 përqind e popullatës besojnë se për ta është e mundshme të hasin në presion nga ndonjë zyrtar publik, për të dhënë formë ryshfeti në mënyrë që problemi të zgjidhet (Figura 12). Ky perceptim i lartë i **mundësisë së presionit korruptiv** në Kosovë, është i krahasueshëm me atë të rajonit (shih SELDI 2016), dhe demonstroi përhapjen e problemit në Evropën Juglindore.

Në anketën e CMS-së, **mjedisi** i korrupsionit vlerësohet më tej bazuar në perceptimin e përhapjes së korrupsionit mes **institucioneve** të ndryshme **publike**. Institucionet mes tri shtyllave kryesore të qeverisjes, ekzekutivi, legjislativi, dhe gjyqësori, janë perceptuar si tri institucionet më të korruptuara. Qeveria ka indeksin më të lartë të korrupsionit të perceptuar, barazi me 3, në shkallë nga 1 deri në 5. Pasojnë Kuvendi dhe gjykatat me 2.7 dhe 2.6 respektivisht.

FIG. 12 Perceptimet e mundësisë së presionit për korrupsion (%)



SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

TAB. 02 Vlerësimi i korrupsionit në institucionet publike

Sipas jush, cila është shkalla e përhapjes së shpejtë të korrupsionit në institucionet në vazhdim?

5= I përhapur deri në shkallën më të lartë
1= Fare i pa përhapur

| | |
|----------------------------|------|
| Qeveria | 3.01 |
| Kuvendi | 2.68 |
| Gjykatat | 2.64 |
| Prokuroria | 2.58 |
| Qeveria komunale | 2.58 |
| Hetuesia | 2.57 |
| Agjencia e Privatizimit | 2.55 |
| Administrata Tatimore | 2.55 |
| Doganat | 2.54 |
| EULEX-i | 2.44 |
| Administrata komunale | 2.43 |
| KEDS-i | 2.39 |
| Telekomi i Kosovës | 2.38 |
| Zyra Kombëtare e Auditimit | 2.38 |
| Policia | 2.25 |
| Banka Qendrore e Kosovës | 2.06 |
| Presidenca | 1.99 |
| Ushtria | 1.52 |

BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2016

FIG. 13A Perceptimet e korrupsionit të zyrtarëve publik – më të korrupsuarit

Zyrtarët të perceptuar si më të korrupsuarit në shkallë nga 1 deri 4, ku 1 është "Pothuajse askush nuk është i përfshirë" dhe 4 është "Pothuajse të gjithë janë të përfshirë"





FIG. 13B Perceptimet e korrupsionit të zyrtarëve publik – më së paku të korrupsuar

Officials perceived as least corrupted on a scale from 1 to 4, where 1 is "Almost no one is involved" and 4 is "Almost everybody is involved"



Institucionet më së paku të korrupsuara janë perceptuar të jenë ushtria, presidenca dhe banka qendrore. Tabela 2 tregon në më shumë detaje se si vlerësohet korrupsioni në secilin institucion publik.

Sipas rezultateve të anketës, më shumë se 60 për qind e të anketuarve besojnë që korrupsioni është i përhapur mes **të gjithë** ose **shumicës së zyrtarëve publik**. Përderisa, kur janë pyetur të rendisin përhapjen e korrupsionit në institucione publike sipas vendeve të ndryshme të punës, zyrtarët Qeveritarë janë vlerësuar si zyrtarët më të korrupsuar. Figura 13a tregon që në shkallë nga 1 deri në 4, zyrtarët e

perceptuar si më të korrupsuar janë: Ministrat (2.9), Zyrtarët në Ministri (2.9), Anëtarët e Kuvendit (2.9), Gjyqtarët (2.7), Partitë Politike (2.9) dhe Liderët e Koalicioneve (2.9). Në anën tjetër, zyrtarët më së paku të korrupsuar (shih Figurën 13b) janë konsideruar: Zyrtarët Hetimorë (2.6), Zyrtarët Policor (2.6), Avokatët (2.4), Gazetarët (1.9) dhe Mësuesit (1.5).

Të gjitha këto kategori të zyrtarëve publik, janë vlerësuar me nivele lehtësisht më të ulëta të korrupsionit të perceptuar në 2016-tën, krahasuar me 2014-tën. Një mbështetje e mundshme në zvogëlimin e nivelit të korrupsionit të perceptuar, tregohet në Figurën 11

Tabela 3 prezanton përqindjen e popullatës e cila beson që shumica ose të gjithë **zyrtarët publik** në fjalë, janë të përfshirë në korrupsion. Sektorët me nivelin më të lartë të korrupsionit të perceptuar janë shënuar me të kuqe të mbyllët, korrupsioni i nivelit-mesatar është shënuar me të kuqe të ndritshme dhe të verdhë, dhe niveli i ulët i korrupsionit nuk është ngjyrosur.


Të dhënat e kësaj table tregojnë që perceptimi i korrupsionit për zyrtarët publik në Kosovë është i renditur në një radhë të ngjashme me vendet tjera, edhe pse përqindjet e perceptimit të korrupsionit në Kosovë në këto grupe të zyrtarëve, janë nën pozicionin e mesatares e korrupsionit të perceptuar në vendet tjera (të shënuara me kuti më pak të kuqe, në tabelën më poshtë).

TAB. 03 % e të anketuarve të cilët besojnë që shumica ose të gjithë zyrtarët në fjalë janë të përfshirë në korrupsion

| Zyrtarët/Grupet | Bullgaria | Shqipëria | Serbia | Maqedonia | Mesatarja | Kroacia | Bosnja dhe Hercegovina | Kosova | Mali i Zi | Turqia |
|---|-----------|-----------|--------|-----------|-----------|---------|------------------------|--------|-----------|--------|
| Partitë Politike dhe Liderët e Koalicioneve | 78% | 80% | 77% | 66% | 68% | 69% | 73% | 66% | 56% | 46% |
| Anëtarët e Kuvendit | 81% | 83% | 76% | 66% | 67% | 70% | 58% | 61% | 48% | 61% |
| Ministrat | 77% | 83% | 71% | 67% | 67% | 66% | 64% | 64% | 52% | 56% |
| Liderët e Partive Lokale | 72% | 76% | 80% | 62% | 66% | 72% | 72% | 59% | 54% | 46% |
| Zyrtarët Doganorë | 89% | 83% | 78% | 64% | 64% | 55% | 53% | 45% | 49% | 60% |
| Gjyqtarët | 84% | 87% | 61% | 70% | 61% | 63% | 53% | 52% | 45% | 39% |
| Zyrtarët në Ministri | 73% | 78% | 53% | 59% | 59% | 55% | 55% | 65% | 41% | 51% |
| Prokurorët Publik | 82% | 80% | 55% | 63% | 58% | 58% | 50% | 50% | 42% | 39% |
| Zyrtarët Tatimor | 70% | 70% | 63% | 63% | 57% | 56% | 50% | 43% | 43% | 57% |
| Këshilltarët Komunal | 73% | 66% | 72% | 56% | 57% | 59% | 52% | 37% | 46% | 54% |
| Zyrtarët Policor | 78% | 63% | 66% | 57% | 56% | 49% | 56% | 35% | 48% | 54% |
| Zyrtarët Komunal | 66% | 78% | 55% | 55% | 56% | 52% | 51% | 48% | 42% | 56% |
| Avokatët | 78% | 74% | 57% | 59% | 56% | 63% | 44% | 36% | 43% | 48% |
| Zyrtarët Hetimor | 76% | 73% | 55% | 55% | 53% | 41% | 52% | 43% | 39% | 44% |
| Zyrtarët e Administratës në sistemin gjyqësor | 62% | 80% | 51% | 57% | 53% | 42% | 49% | 49% | 36% | 47% |
| Mjekët | 69% | 72% | 51% | 52% | 52% | 49% | 56% | 49% | 49% | 25% |
| Ndërmarrësit (biznismenet) | 67% | 48% | 69% | 54% | 51% | 56% | 45% | 33% | 34% | 51% |
| Zyrtarët universitar ose Profesorët | 55% | 58% | 33% | 50% | 42% | 39% | 42% | 45% | 29% | 24% |
| Bankierët | 65% | 25% | 34% | 41% | 36% | 50% | 24% | 16% | 30% | 35% |
| Përfaqësuesit e Organizatave Jo-Qeveritare | 42% | 23% | 52% | 42% | 34% | 35% | 30% | 26% | 27% | 30% |
| Gazetarët | 41% | 29% | 47% | 49% | 34% | 32% | 30% | 17% | 26% | 31% |
| Mësuesit | 17% | 26% | 25% | 25% | 19% | 20% | 20% | 10% | 15% | 11% |

BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2016

FIG. 14 Perceptimet e fizibilitetit të reagimit të politikave ndaj korrupsionit (%)



BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2014, 2016

Perceptimet publike janë po ashtu mjet për vlerësimin e përpjekjeve anti-korrupsion. Pritjet e njerëzve rreth çrrënjësjes potenciale të korrupsionit shpjegojnë besimin e tyre në efikasitetin e politikave anti-korrupsion. Në Kosovë, rezultatet minore të luftës së gjatë kundër korrupsionit kanë kontribuar në një rënie të optimizmit. Figura 14 tregon që pjesa e popullsisë e cila beson që **korrupsioni nuk mund të reduktohet krejtësisht** ose çrrënjësohet, është ngritur nga 49 përqind në 2014-tën, në 63 përqind në 2016-tën

Pritjet rreth ndryshimeve në nivel lokal, normalisht janë të influencuara nga zhvillimet në rajon. Qytetarët i referohen historisë së vendeve fqinje me nivele të ngjashme të zhvillimit, në mënyrë që të krijojnë një pamje më të mirë të situatës së tyre dhe të ardhmes. Perceptimet e Kosovarëve rreth përhapjes së korrupsionit në vendet e Evropës Jug-Lindore janë zhvilluar përmes përvojës direkte me vendin, ose përmes influencës së tjera si mediave apo bisedave.

Tabela 4, së pari tregon që sipas perceptimit gjeneral korrupsioni është shumë i përhapur në Kosovë. Qytetarët e perceptojnë Kosovën si vendin më të korruptuar në rajon, me një indeks prej 3.4, në një shkallë prej 1 deri në 5. Vendet fqinje, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi, radhiten menjëherë pas në listë si vendet më të korruptuara me indekse të barabarta me 3.2, 3.2 dhe respektivisht 2.9. Përderisa, në fundi i radhitjes tregon që Kosovarët i perceptojnë Turqinë dhe Kroacinë si vendet më së paku të korruptuara.

TAB. 04 Perceptimi i përhapjes së korrupsionit në vendet e Evropës Jug-Lindore

Sipas jush, deri në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në vendet në vijim?
5= përhapja është në nivelin më të lartë;
1= i pa përhapur fare

| | |
|------------------------|------------|
| Kosova | 3.4 |
| Shqipëria | 3.2 |
| Serbia | 3.1 |
| Mali i Zi | 2.9 |
| Maqedonia | 2.9 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 2.7 |
| Bullgaria | 2.6 |
| Rumania | 2.6 |
| Turqia | 1.9 |
| Kroacia | 1.8 |

BURIMI: SELDI/ SISTEMI I MONITORIMIT TË KORRUPSIONIT 2016

Vlerësimi i **mjedisit të korrupsionit** ka konfirmuar edhe një herë seriozitetin e problemit të korrupsionit në Kosovë. Perceptimet e qytetarëve rreth presionit korruptiv janë të larta dhe tregojnë që problemi është i shpërndarë në degët kryesore të qeverisjes, duke përfshirë qeverinë, kuvendin, dhe gjykatat. Përveç kësaj, mendimi gjeneral tregon se një pjesë të popullsisë në rritje duke humbur besimin në vazhdimësi, në mundësinë për të reduktuar ndjeshëm ose çrrënjësuar korrupsionin.

2

Rishikim i zhvillimeve të fundit të korrupsionit dhe anti-korrupsionit në Kosovë

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET ANTI-KORRUPSION

Kosova ka bërë luftën kundër korrupsionit prioritet në agjendën kombëtare. Korniza ekzistuese ligjore kundër korrupsionit në Kosovë, ofron shumë mundësi për të luftuar korrupsionin. Megjithatë, numri i trupave dhe agjencive të krijuara për të luftuar korrupsionin janë në disproporcion të lartë me rezultatet aktuale. Në vitet e fundit, Kosova ka zhvilluar një tendencë për të krijuar institucione të reja anti-korrupsion, në vend se ta luftoj atë me institucionet ekzistuese. Korrupsioni dhe lufta kundër tij, është temë kryesore në mediat lokale. Thirrjet e shpeshta nga komuniteti ndërkombëtar për ta luftuar korrupsionin, mbesin qasja kryesore ndaj Kosovës. Edhe pse qeveria zotohet që do ta luftoj korrupsionin, gjasat që kjo të ndodhë janë minimale.

POLITIKAT ANTI-KORRUPSION DHE MJEDISI RREGULLATIV

Agjencia Kundër-Korrupsion (AKK) është institucioni më i dukshëm mes institucioneve anti-korrupsion. Luan rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. AKK është një institucion i pavarur i themeluar në vitin 2006. Pasi që mandati i Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kosovës në formën momentale derivon nga Ligji kundër Korrupsionit (2004/34), është i fokusuar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpiqet në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe ngritjen e vetëdijes, në mënyrë që të ndërtojë një shoqëri të shëndoshë, të bazuar në sundim të ligjit. Si për ironi, edhe pse Agjencia luan rolin më të rëndësishëm, nuk posedon mekanizmat e duhur ligjor për të ushtruar këto aktivitete të ndërlidhura të korrupsionit¹. Artikujt 16 dhe 17 të Ligjit mbi Agjencinë Kundër-Korrupsion, i japin Agjencisë përgjegjësinë për të përgatitur Strategjinë dhe Planin e Veprimtimit kundër korrupsionit, në përputhje me institucionet tjera. Buxheti i AKK-së për vitin 2016 ishte 501,666 euro, një rritje nga 397,851 euro, sa ishte në vitin

1 Kosovo Democratic Institute (2015), National Integrity System Assessment Kosovo

2012, por po ashtu edhe rritje në numrin e stafit në 39 zyrtarë civil. Rritja e re në buxhetin e Agjencisë nuk është e mjaftueshme dhe nuk është në linjë me trendët e reja të ngritjes totale të buxhetit. Po ashtu, ajo çka e bën më të vështirë punën e AKK-së është paaftësia për të proceduar me kallëzimet penale kur kanë fakte për korrupsion.

Në Janar të 2013-tës, Kodi i ri Penal i amendamentuar hyri në fuqi. Sipas Ligjit të ri, korrupsioni është vepër penale i cila manifestohet në vetvete si: abuzim i pozitës ose autoritetit zyrtar; konflikt ose interes; shpërdorim në zyrë; mashtrim në zyrë; përdorim i paautorizuar i pronës; pranimi i ryshfetit; dhënia e ryshfetit zyrtarit të huaj publik; tregtimi i influencës; dështimi për të raportuar ose raportimi fals i pronës, të hyrave, dhuratave ose materialeve tjera përfituese ose obligimeve financiare, dhe mbledhjes së pa ligjshme dhe shpagimit.² Ligjet tjera të cilat merren me sektorin e korrupsionit dhe anti-korrupsionit, përpos Ligjit Penal, janë ligjet mbi prokurimin publik, qasjet në dokumente zyrtare, ligji mbi deklarimin, prejardhja dhe kontrolli i pronës së zyrtarëve të lartë publik dhe i deklarimit, prejardhja dhe kontrolli i dhuratave i të gjithë zyrtarëve publik, konflikti i interesit dhe ligji mbi zgjedhjet.

² Official Gazette of Republic of Kosovo - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

STRATEGJIA E RE ANTI-KORRUPSION DHE PLANI I VEPRIMIT

Strategjia e fundit Anti-korrupsion dhe Plani i Veprimit për vitet 2009-2011 nuk është përcjellë me një strategji të re. Drafti për Strategjinë dhe Planin e Veprimit anti-korrupsion 2012-2016 nuk ka kaluar në Kuvend. Megjithatë, në Shkurt 2013, Strategjia dhe Plani i ri i Veprimit, janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo strategji është kontestuar fuqishëm nga anëtarët e partive opozitare dhe organizatat e shoqërisë civile. Edhe pse në strategji është përmendur që të gjitha institucionet dhe organizatat relevante nga shoqëria civile janë konsultuar, Forumi konsultativ i OJQ-ve, e ka konsideruar strategjinë Anti-korrupsion si “*shumë të dobët në përmbajtje, e cila në vend se ta luftojë korrupsionin, e legjitimon atë*”³. Si rrjedhojë, shoqëria civile pretendon që ata nuk janë konsultuar fare në hartimin e strategjisë, por vetëm janë kontaktuar sipërfaqësisht, përkundër rekomandimeve të panumërta nga institucionet ndërkombëtare që të përfshijnë shoqërinë civile në proces. Strategjia e re ka ndjekur strukturën e dokumentit paraprak, pasi që përmban objek-

³ Kosova Democratic Institute (2015) – National Integrity System Assessment Kosovo; Gazeta Jeta ne Kosove, Strategjia Kunder Korrupsionit Pa efekt ne Praktike.

tiva horizontal (të kombinuar) si dhe objektiva specifike në çdo sektor prioritar vertikal. Megjithatë, objektivat nuk janë formuluar në një mënyrë e cila reflekton nevojat specifike të momentit, si rezultat i vlerësimit të rrezikut. Andaj, ato mund të rigrupohen në këto kategori: Parandalim, Fuqizim i Ligjit, Ndjekje Penale, Bashkëpunim Ndër-institucional dhe Ngritje e Vetëdijes⁴.

Qëllimi kryesor i strategjisë së re anti-korrupsion, është që të kontribuohet në zvogëlim progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, fuqizim i integritetit dhe ndërtim i besimit publik në qeveri dhe institucione publike, të promovohet parimi i zero-tolerancës ndaj korrupsionit, të implementohen standarde internacionale kundër korrupsionit të cilat të cilat do të ndihmonin sundimin e ligjit në Kosovë, dhe të jenë efektive dhe funksionale. Po ashtu, strategjia do të ndihmojë strukturat qeveritare për të ndryshuar kulturën e tyre institucionale kundër korrupsionit, dhe një qasje më të orientuar nga rezultatet. Kjo kërkon një përkushtim pro-aktiv nga të gjitha institucionet publike, trupat tjera të pavarura, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar⁵.

Disa prej prioriteteve dhe objektivave të reja të cilat derivojnë nga vlerësimi i Planit të fundit të Veprimit anti-korrupsion (2006-2011) janë: Adresimi i nivelit të ulët të besimit në institucione publike, politike, gjyqësor dhe administratë; Politika parandaluese dhe inkurajimi i mekanizmave për largimin e bindjes; niveli i fuqizimit të ligjit duhet të jetë në ngritje; politika e vendosjes së sanksioneve në vend për mos implementimin e legjislaturës duhet të rishikohet në mënyrë që të jetë më efektive. Prioritet duhet ti jepet agjencive të fuqizimit të ligjit (policisë, zyrtarëve të taksave dhe doganave) prokurorisë dhe gjykatave; bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar, në veçanti EULEX-in, si dhe duhet të bëhet fuqizimi i shoqërisë civile⁶.

4 Anti Corruption Agency (2013). Strategjia dhe Plani i Veprimit Kunder Korrupsionit (2013-2017). Retrieved from: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_kunder_Korrupsionit_2013-2017.pdf

5 Ibid.

6 Ibid.

ORGANET E TJERA QË KONTRIBUOJNË NE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në këtë pjesë do të prezantojmë një përmbledhje të punës së institucioneve dhe organeve tjera në luftën kundër korrupsionit. Zhvillimet dhe ndryshimet e fundit në kornizën legjislative nga Raporti i fundit Vlerësimit të Korrupsionit në Shtet janë po ashtu të theksuara.

Organet tjera kombëtare që kanë juridiksion në luftën kundër korrupsionit janë: Kryeprokurori i Shtetit, Task-Forca kundër korrupsionit, Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, Zyra e Auditorit Gjeneral, Departamenti për Investigime Ekonomike dhe Krime të Korrupsionit dhe po ashtu misioni i EULEX-it në Kosovë. Roli i këtyre organeve mbetet mjaft kontravers dhe ekziston një konsensus i gjerë në shoqëri që vendosja e mekanizmave të ndryshme dhe krijimi i task forcave e rrezikojnë implementimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese, duke shpenzuar buxhet në drejtime të ndryshme pa ndonjë rezultat të kënaqshëm në luftën kundër korrupsionit dhe me numër të vogël të dënimeve.

Njëri nga institucionet më të rëndësishme është edhe Zyra e Kryeprokurorit të Shteti, megjithatë roli i tij në luftimin e korrupsionit mbetet shumë i vogël. Disa nga arsyet e identifikuar përse Zyra e Kryeprokurorit është joefikase janë buxheti i vogël dhe burimet e pamjaftueshme. Deri më 2015, Qeveria kishte kontroll të plotë mbi ZKSh. Me ndryshimet e reja në ligj, pavarësia e ZKSh është përmirësuar sado pak⁷. Në kuadër të kësaj zyreje ishte themeluar 'Grupi i Prokurorëve kundër Korrupsionit' me qëllimin kryesor që ta luftoj korrupsionin, megjithatë, më 1 Dhjetor 2013 ky Grup është shpartalluar në baza të mungesës së rezultateve. Sipas ZKSh, të gjitha rastet e korrupsionit do të shpërndahen proporcionalisht tek të gjithë prokurorët dhe do të trajtohen si të gjitha veprat tjera penale⁸. Njëra nga rekomandimet konstante që i jepet qeverisë është nevoja për të forcuar rolin e ZKSh dhe të rrisë autoritetin e Kryeprokurorit dhe prokurorëve.

Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit është themeluar në Shkurt 2012 nga ish-Presidentja Atifete Jahjaga me qëllim të koordinimit të punëve dhe aktiviteteve të institucioneve dhe agjencive në kuadër të kompetencave dhe fushës së

7Kosova Democratic Institute (2015), National Integrity System Assessment Kosovo

8Gazeta Express (2013), 'Shpartallohet grupi i prokurorëve'. Retrieved from: http://www.gazetaexpress.com/arkiva/shpartallohet-grupi-i-prokuror-235-ve-kund-235-r-korrupsionit-rezultati-zero-127612/?arch_tb=temp

TAB. 05 Kallëzimet penale në punë dhe kallëzimet penale të proceduara për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nga totali i të gjitha prokurorive regjionale.

| Veprat Penale | 2013 | | | 2014 | | | 2015 | | |
|--------------------|---------|---------------|-------|---------|---------------|-------|---------|---------------|-------|
| | Në punë | Të proceduara | % | Në punë | Të proceduara | % | Në punë | Të proceduara | % |
| Korrupsioni | 778 | 314 | 40.36 | 976 | 444 | 45.49 | 950 | 412 | 43.37 |

BURIMI: PERFORMANCA E PROKURORIVE (2016), RAPORTI ANALITIK TRE VJECAR

studimit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Disa nga funksionet e Këshillit janë: të koordinoj aktivitetet në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit; të identifikojë dhe të koordinoj aktivitetet në përkrahje të zbatimit të strategjisë kombëtare në luftimin e korrupsionit; të përcaktoj prioritetet dhe politikat për zbatimin e agjendës legjislative në ngritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit; të koordinoj punën e aktivitetet e institucioneve përgjegjëse në forcimin e mekanizmave ekzistues për luftimin e korrupsionit; të rrisë vetëdijen e shoqërisë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit shihet si shembull i shumë organeve dhe agjencive që janë themeluar në vitet e fundit me qëllim kryesor për ta luftuar korrupsionin. Ky Këshill nuk mbledhet rregullisht dhe deri më tani nuk ka prodhuar ndonjë rezultat të kënaqshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është institucion i pavarur i cili i raporton Kuvendit të Kosovës. Në vitin 2016 ky institucion kishte në përbërje 141 shërbyes civil dhe 5 zyrtarë publik. ZAP i raporton për punën e tij direkt Kuvendit të Kosovës, konkretisht, Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. ZAP cilësohet si një institucion që ka performancë të mirë dhe punon profesionalisht ⁹.

Si rezultat i mungesës së besimit në institucione, në Mars të vitit 2015 është aprovuar Kodi i Etikës për shërbyes civil, duke kontribuar kështu në zhvillime pozitive me gjithë mungesën e rezultateve në terren. Faktor tjetër që pengon sundimin e ligjit është mospërfillja e vazhdueshme e qeverisë ndaj rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe Avokatit të Popullit. Sipas ligjeve në fuqi dhe Kodit të Sjelljes, gjykatësit dhe prokurorët janë të obliguar të deklarojnë pasurinë dhe dhuratat e pranuar. Zyra për Këshill Disiplinor/Prokurori (ZKD/ZKP) ka suspenduar një gjykatës për shkak të akuzave

për marrje rryshfeti ¹¹.

Janë bërë disa ndryshime të tjera në kornizën ligjore për anti-korrupsion, si mbi deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pronës së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, origjina dhe kontrolli i dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Po ashtu pragu për deklarimin e pronave të luajtshme është ulur nga 5 000 euro në 3 000 euro. Këto masa kanë bërë që të sigurohet që krimet që kanë të bëjnë me korrupsionin të kriminalizohen ¹².

ZBATIMI I LIGJIT DHE PRAKTIKAT INSTITUCIONALE

Kosova vazhdon të ketë sistem të dobët të drejtësisë, i njollësuar nga konfliktet e interesit, ndërhyrjet politike dhe mungesës së burimeve për ta ushtruar ligjin. Përplasjet e vazhdueshme në mes të partive politike që janë duke ndodhur në Kosovë në këto dy vitet e fundit kanë kontribuar edhe më shumë në bllokimin e punës së Kuvendit, kështu duke ndikuar në funksionimin e duhur të punës së Kuvendit.

Është e rëndësishme të theksohet që Kuvendi duhet të mbikëqyrë agjencitë kryesore që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit përmes Komisioneve Parlamentare. Një qështje tjetër me rëndësi është nevoja për zbatimin e masave ndëshkuese që do të kontrollonin institucionet e pavarura dhe në veçanti agjencinë e pavarura që merren me luftën kundër korrupsionit. Shoqëria civile ka qenë në vazhdimësi e vendosur në kërkesat e saj që Kuvendi i Kosovës duhet sa më parë të adoptojë legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, depolitizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të adoptoj ligjin mbi partitë politike për

⁹ Webfaqja Zyrtare e Republikës së Kosovës. Marrë nga: <http://ëëë.president-ksgov.net/?page=1,132>

10GAP (2016), Institucionet dhe Agjencitë e Pavarura në Kosovë.

¹¹European Commission (2015), Kosovo Progress Report

¹² Ibid.

një sistem më të mirë dhe transparent ¹³. Në vitin 2015, AKK ka zhvilluar procedurat paraprake në gjithsej 354 raste nga të cilat 56 prej tyre janë bartur nga viti i kaluar. 126 raste nga 298 të tilla për vitin 2015 janë dërguar në prokurori dhe polici për procedim të mëturshëm. Numri i zyrtarëve që kanë deklaruar pasuritë e tyre për vitin 2016 brenda afatit ligjor ka qenë 4 320 ose 99,26%, një rritje prej 98,3% nga viti 2015 (Agjencia Kundër Korrupsionit, 2016).

Raporti i fundit i Vlerësimit të Korrupsionit (CAR) ka kritikuar kufizimet e masave ndëshkuese që Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) në Kosovë ndërmerr dhe përdorimin e burimeve të saj pothuajse tërësisht në drejtim të parandalimit të korrupsionit (jo për të ndëshkuar atë). Gjersa deri më tani kjo ende mbetet një kritikë e vlefshme, ne më tej konsiderojmë se AKK kryen një mision të ekzagjeruar i cili është shumë i gjerë për ta përfunduar, dhe që ka çuar në sukses minimal të agjencisë. AKK është sipas ligjit përgjegjëse për një lloj të luftës së përgjithshme të korrupsionit të të gjitha llojeve në Kosovë, duke përfshirë monitorimin e shpalosjes së pasurisë të zyrtarëve publikë, monitorimin e prokurimit publik, kodin etik të zyrtarëve publikë dhe të marrjes së ankesave nga qytetarët. Kompetencat e agjencisë bien po ashtu ndesh me ndjekjen penale të veprave kriminale që ndërmerr drejtësia. Kryeprokurori i Shtetit pa dyshim mbetet një organ më i kualifikuar për të punuar në hulumtimin dhe parandalimin e korrupsionit, por megjithatë përzierja e kompetencave me AKK krijon paqartësi në shmangien e përgjegjësisë nga të dyja institucionet. Kështu që, rekomandohet që AKK ti nënshtrohet një lloj rimodelimi dhe ridefinimi të misionit të saj. Një alternativë tjetër mund të jetë zvogëlimi i detyrave të agjencisë në deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik. Më konkretisht, agjencia do të fokusohet në kontrollin e vlefshmërisë dhe saktësinë e të dhënave, një fushë në të cilën agjencia ka dalë të jetë mjaft e suksesshme.

Të gjeturat kryesore në raportin e progresit për Kosovën njohin një përparim të qëndrueshëm në kornizën ligjore për anti-korrupsion i cili është vërtetuar edhe nga vlerësimet faktike në fusha të tjera. Megjithatë, llogaridhënia dhe efikasiteti i gjyqësorit në përgjithësi dhe në prokurimin publik në veçanti ka nevojë për përmirësime të mëdha, dhe konsultimet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile duhet të intensifikohen. Mungesa e një historiku që do të tregoj rastet e suksesshme të prokurorisë është një temë që përsëritet

në raportin e progresit ¹⁴. Në përgjithësi, Kosova është ende në fazë të hershme të përputhjes së legjislacionit në shumicën e fushave me të Bashkimit Evropian.

Hapi tjetër i ndërmarrë si pjesë e zbatimit të ligjit është përmirësimi i infrastrukturës në sistemin e drejtësisë. Pallati i Drejtësisë është inauguruar në Mars 2015 me qëllim të ofrimit të një infrastrukture të plotë për një numër të gjykatave. Ky zhvillim është pjesë e përpjekjeve të ndërmarra nga institucionet kosovare në luftën kundër korrupsionit. Që nga hapja e Pallatit të Drejtësisë janë hasur shumë probleme në ndërtimin e tij ¹⁵. Gjykatat e Kosovës tani kanë një raport prej 84% të rasteve të zgjidhura brenda një viti. Megjithatë, pasi që sipas ligjit koha që nevojitet për ti hulumtuar rastet e korrupsionit është shumë e shkurtër, krijohen ngecje të tjera tek gjykatat për të marrë vendime më të shpejta ¹⁶.

Pavarësisht përparimit që është arritur në përmirësimin e legjislacionit kundër korrupsionit, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 thekson mangësi në kornizën strategjike të luftës kundër korrupsionit “[...] financimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e çfarëdoshme e treguesve të matshëm të ndikimit janë duke dëmtonuar seriozisht rezultatet e pritura” (Komisioni Evropian, 2016).

KORRUPSIONI DHE EKONOMIA

Situata ekonomike në Kosovë mbetet e vështirë dhe problemet më të mëdha që shoqëria kosovare ballafaqohet për vite të tëra janë papunësia dhe mungesa e perspektivave ekonomike. Sektori i Biznesit ka një performancë të dobët dhe nuk po tregon shenja të përmirësimit. Shteti vazhdon të ndërhyjë në sektorin e biznesit, ndërkohë që sektori i biznesit ankohet për metodat e korrupsionit në vend që ata duhet ti respektojnë që të kenë rezultate të dëshirueshme, të tilla si pagesat joformale për zyrtarët komunal për të marrë shërbimet komunale ¹⁷. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka pasur deri kohët e fundit një bord të kompletuar dhe si në rastin e bordeve të tjera të agjencive të pavarura është kritikuar që është shumë i politizuar nga

13 KDI (2015). Vlerësimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë

14 European Commission (2015), Kosovo Progress Report.

15 Kallxo (2015) - <http://kallxo.com/bie-nje-pllake-e-tavanit-ne-pallat-te-drejtësisë/>; Kallxo (2016) - <http://kallxo.com/ashensoret-e-pallatit-te-drejtësisë-jashte-funksionit/>

16 European Commission (2015), Kosovo Progress Report

17 KDI (2015). Vlerësimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë.

partitë politike në pushtet. Për më tepër, nivelet e larta të ekonomisë joformale dhe krimi i organizuar janë identifikuar në vazhdimësi nga bizneset vendore si arsyt kryesore që pengojnë funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut në Kosovë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) vendore kanë probleme me konkurrencën e lirë, duke i'u dashur të konkurrojnë me firma të huaja dhe edhe pse Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim me Bashkimin Evropian, mbetet skeptike se sa shpejtë mundem firmat lokale të konkurrojnë në tregun Evropian. Paguesat informale janë një tjetër çështje që është raportuar në Kosovë, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë. Gjithashtu, në progres raportet për vitet 2014 dhe 2015 janë identifikuar dobësitë strukturore në mjedisin ekonomik:

“Përpjekje të konsiderueshme afatgjate janë të nevojshme për të trajtuar dobësitë strukturore dhe për të përballuar presionet konkurruese mbi forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian” (KE, 2014).

Rryshfeti në sektorin privat dhe publik është një tjetër problem që sektori i biznesit bllafaqohet në vazhdimësi. Dhënia e rryshfetit është i përhapur jo vetëm në mes kompanive private dhe zyrtarëve publikë, por edhe mes vetë bizneseve. Shumica e bizneseve pohojnë se rreziku i korrupsionit dhe krimi të organizuar ka qëndruar i njëjtë përgjatë viteve të fundit¹⁸. Bizneset ankohen për nivelin e lartë të burokracisë në prokurimin publik dhe ata kanë probleme në të kuptuarit se si burokracia në të vërtetë funksionon. Për më tepër, një prokurimi publik joefikas ndihmon keq menaxhimin e procedurave të tenderimit.

Sfidat në fushën e anti-korrupsionit pengojnë funksionimin e duhur të forcave të tregut. Korrupsioni i përhapur në kombinim me institucione të dobëta vazhdojnë të pengojnë mjedisin e biznesit. Privatizimi në këtë ditë është i njollësor me akuzat për korrupsion. Siç edhe theksohet në raportin e progresit për vitin 2015:

“Statusi i pazgjidhur i të drejtave pronësore dhe procedurat e gjata ligjore që kanë të bëjnë me pretendimet financiare të aseteve të privatizuara pengojë procesin e privatizimit dhe vonojnë shpërndarjen e të mjeteve të privatizimit të mbajtura në bankën qendrore” (Komisioni Evropian, 2015).

Nivelet e larta të korrupsionit janë theksuar në raportin e progresit të ekzistojnë edhe në sektoret e tjera si në do-

gana dhe Administratë Tatimore, shërbimet shëndetësore dhe në sektorin e edukimit, sektor që mbetet një fushë me rrezik të lartë për korrupsion, veçanërisht në nivelin e arsimin universitar.

PROKURIMI PUBLIK DHE KORRUPSIONI

Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë ka themeluar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për të pasur një përgjegjësi kryesore të funksionimit të përgjithshëm të rregullave dhe sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë. Prokurimi publik vazhdon të mbetet i parregullt me zyrtarë publikë të korruptuar të cilët i keqpërdorin fondet publike për përfitime personale. Prokurimi publik është veçanërisht i prirur për të qenë i korruptuar, tej masë e politizuar dhe është kritikuar vazhdimisht për mungesë të transparencës dhe përgjegjësisë (EC, 2015). Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik thekson sfidat që hasin gjatë implementimit të legjislacionit të prokurimit publik pavarësisht përpjekjeve të dhëna në reformat e legjislacionit.

Gjithashtu, ka një mungesë në publikimin e raportit të shpenzimeve, transparencës buxhetore dhe planit të prokurimit nga Qeveria e Kosovës. Shumë prej ministrave nuk i publikojnë njoftimet e kontratave në faqet e tyre të internetit. Përkundër faktit se shumë nga dokumentet kyçe buxhetore në Kosovë janë të publikuara për publikun, asnjë prej këtyre dokumenteve nuk janë të paraqitura në një format lehtë të lexueshme (duke përfshirë këtu edhe statistikat e vendit të nxjerra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës). Format i raportimit të buxhetit ka mungesë të transparencës dhe metodologji të papërshtatshme të raportimit. Shumica e ministrave publikojnë dokumente zyrtare të buxhetit si raporte përfundimtare pa dhënë informacion më të detajuar. Për vitin raportues 2015, nga të gjitha ministratë (19 ministri në total) në Kosovë, vetëm Ministria e Drejtësisë arriti të sigurojë shpenzimet buxhetore në një format të detajuar të cilat mund të gjenden lehtë për përdorim publik.

Megjithëse KRPP është ligjërisht përgjegjëse për të publikuar tenderët e suksesshëm dhe kontratat, do të ishte e dobishme për qytetarët që të marrin informacion të drejtpërdrejtë prej një faqeje interneti të centralizuar të Qeverisë. Në vitin 2015 dhe 2016, disa hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për të zbatuar një sistem të centralizuar të prokurimit. Prokurimi qendror do të përmirësonte kapacitetet aktuale, të rrit kapacitetet administrative, si dhe të rrit efikasitetin. Në raportin e progresit të vitit 2015 është

18 UNODC (2013), Business, Corruption and Crime in Kosovo.

theksuar se duhet të ketë përmirësim të vazhdueshëm në përafrimin e sistemit të prokurimit publik të Kosovës me legjislacionin të BE-së. Kur përmendet prokurimi publik, Kosova ka probleme me zbatimin e sanksioneve ligjore mbi korrupsionin dhe praktikën mashtruese, si dhe nivelet e larta të korrupsionit vazhdojnë të mbeten shqetësimi kryesor për prokurimin publik.

Raporti i Progresit thekson se një nga kritikën e vazhdueshme është dështimi i institucioneve përkatëse për të zbatuar praktikën e duhura disiplinore. Shumë OJQ kanë identifikuar abuzimin e ligjit në prokurim publik, pasi që shumë prej tenderëve publikë jepen për biznesmenët e afërt me politikanët. Me miratimin e ligjit të ri për prokurimin publik është përmendur pozita e një eksperti të prokurimit, një pozicioni i cili në ligjin e vjetër nuk ekzistonte. Gjatë periudhës 5 Janar 2015 deri më 31 Dhjetor 2015, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka pranuar 592 ankesa për prokurimin publik, publiko-privat dhe ankande, të cilat kanë kundërshtuar vendimet e autoriteteve kontraktuese për të shpallur fituesin, në vendime të anulimit të aktiviteteve të prokurimit ose kundër favorizuese/ specifitime diskriminuese të shfaqura në dosjen e tenderit.

Bizneset dhe shoqëria civile konsiderojnë si shumë të rëndësishme nevojën për mekanizma më të fortë që do të mund të monitorojnë procesin e prokurimit publik. Me gjithë ndryshimet që janë bërë, besimi i përgjithshëm në një proces të drejtë dhe të paanshëm mbetet sot e kësaj dite shumë i ulët.

SHOQËRIA CIVILE, MEDIA DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË ANTI-KORRUPSION

Udhëzimi i kulturës politike lokale dhe ruajtja e integritetit të qeverisjes publike janë interesa të mëdha për shumë organizata jo-qeveritare. Roli aktiv i shoqërisë civile në rajon ka ndikuar në rritjen e ndikimit të saj në formësimin e opinionit publik, hartimin e ligjeve, dhe kështu duke ndryshuar modelet e vendim-marrjes. Kështu, duke marrë parasysh rëndësinë e shoqërisë civile, ky seksion diskuton praktikën e organizatave jo-qeveritare në Kosovë në fushën e anti-korrupsionit. Aspektet kryesore të adresuara janë gazetaria hulumtuese dhe informatorët, monitorimi i korrupsionit dhe avokim, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Shoqëria civile në Kosovë ka ndjekur një rrugë të transformimit që erdhi nga reagimet e ndryshme të zhvillimeve politike dhe sociale. Numri i OJQ-ve të regjistruara në

Kosovë është rritur dukshëm pas luftës së vitit 1999, edhe pse shumë pak prej këtyre organizatave ishin në të vërtetë aktive. Në vitin 2013, ka pasur 7000 OJQ të regjistruara në Kosovë, por më pak se 10% e tyre kanë funksionuar (Forum 2015).

Në fushën e anti-korrupsionit në Kosovë, ka shumë pak organizata që janë shumë aktive. Siç është paraqitur nga Instituti Riinvest, specializimi i këtyre organizatave është më së shumti në vlerësimin e transparencës institucionale (p.sh KDI- Statuti Ndërkombëtar për Transparencë lokale) ose monitorimit të zbatimit të legjislacionit (p.sh çohu dhe BIRN). Megjithatë, për shkak të qasjes së kufizuar në financa, organizatat janë të detyruara të punojnë me një gamë të larmishme të aktiviteteve dhe nuk mund të specializohen vetëm në një aspekt të korrupsionit.

SHQYRTIMI I PUNËS SË SHOQËRISË CIVILE KUNDËR KORRUPSIONIT

Një tjetër fokus kryesor i shoqërisë civile në Kosovë është korrupsioni dhe avokimi kundër tij. Në mesin e organizatave të përfshira në këtë mision janë që të dyja, ato vendore dhe ndërkombëtare.

UNDP si rrjet global zhvillimor i Kombeve të Bashkuara në masë të madhe prezanton misionin e anti-korrupsionit në Kosovë. Në vitin 2014 dhe 2015, UNDP ka publikuar raporte për korrupsionin në sektorin e edukimit, drejtësisë, si dhe atë të shëndetësisë në Kosovë. Në anketën e tyre vjetore të Pulsit Publik, UNDP ka gjetur se niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave të Kosovës është rritur për 4 për qind gjatë periudhës Shtator 2015 dhe Prill 2016. Ndërsa, niveli i kënaqshmërisë me performancën e prokurorisë ka pasur një rritje të ngjashme, duke nënkuptuar 17% e qytetarëve, në krahasim me 13% të vitit 2015 që kanë qenë të kënaqur me këtë institucion.

Megjithatë, raporti gjithashtu thekson që korrupsioni shihet nga qytetarët e Kosovës si i përhapur pothuajse në të gjitha institucionet, ku Agjencia e Privatizimit të Gjykatave të Kosovës, ofruesit e kujdesit shëndetësor, Administrata Qendrore/ Institucionet, Doganat, dhe Koorporatat Elektrike në Kosovë janë të perceptuara si më të korruptuarat. Sa i përket arsimit, rreziqet më të mëdha të identifikuar nga studimet kanë të bëjnë me prokurimin e teksteve shkollore, pushtetin diskrecional të drejtorëve komunal të arsimit, dhe rreziqet e identifikuar të Universitetit në lidhje me financimin, rekrutimi i stafit akademik dhe prokurimit publik.

Sipas anketës së Pulsit Publik nga UNDP, korrupsioni konsiderohet si problemi i tretë më i madh që po ballafaqohet shoqëria kosovare. Ajo është e ndërlikur shumë dhe shihet si një efekt anësor i papunësisë dhe varfërisë.

Një organizatë tejet aktive e shoqërisë civile është Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Statuti Ndërkombëtar për Transparencë lokale. Raportet e tyre krahasojnë mjediset e korrupsionit dhe anti-korrupsionit të vendeve në Kosovë. Për më tepër, Kosova ka përmirësuar pozitën e saj në radhitjen e Transparencës Ndërkombëtare përmes Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit në vitin 2015, nga vendi 110 tek 103 me një rezultat 33, ku është vendosur shumë afër Shqipërisë si një prej vendeve më të korruptuara në Ballkanin Perëndimor.

TAB. 6 Radhitja ndërkombëtare e transparencës përmes Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit

| Viti | Rradhitja | Rezultati |
|------|------------|-----------|
| 2015 | 103 | 33 |
| 2014 | 110 | 33 |
| 2013 | 111 | 33 |

BURIMI: TRANSPARENCA NDËRKOMBËTARE, INDEKSI I PËRCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT¹⁹

19 Transparency International (2015), Corruption Perception Index. Retrieved from: <http://www.transparency.org/cpi2015>.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Disa shembuj të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e anti-korrupsionit janë prezente në formë të mbështetjes së ndërtimit të institucioneve, monitorimit të korrupsionit dhe bashkëpunimeve të shoqërisë civile.

Synimi për tu bërë anëtarë të Bashkimit Evropian, ju ka dhënë vendeve të Evropës Jug-Lindore korniza (struktura) për të ndjekur.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit është një objektivi i standardeve të monitorimit të pajtueshmërisë që bëhet nga akterët botëror si Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara të kundër Korrupsionit (UNAC).

Sidoqoftë, Kosova për shkak të statusit të saj politik, nuk është anëtare e këtyre organizatave. Si pasojë, përpjekjet e saj për t'u bashkuar organizatave ndërkombëtare janë të fokusuara në mbajtjen e një legjislature të harmonizuar me standardet ndërkombëtare si dhe në monitorimin e reformave në bazë të vlerësimeve të përcaktuara sipas nivelit ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian si pjesë e Instrumentit për asistencë të Para-Anëtarësimi jep një mbështetje Kosovës për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Me marrëveshjen e Stabilizim Asociimit që ka hyrë në fuqi në vitin 2016, Kosova duhet të bëj progres dhe të përpiket në luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të përmbush kërkesat e marrëveshjes.

Sipas Strategjisë për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Maj të vitit 2014, Kosova deri në vitin 2020 duhet të tregoj përparim në: legjislacion më të zgjeruar që të mund të sigurojë pavarësinë e gjyqësorit, trajnime për stafin e gjykatës, pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit, një përmisim të qasjes në drejtësi, sistemi penitenciar të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë kështu trajtime specifike për kategoritë e ndryshme të të arrestuarve.

Përfshirja më e madhe e BE-së në Kosovë është përmes misionit të EULEX-it, puna e të cilit është të mbështesë autoritetet gjyqësore kosovare dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në mënyrë që të përmisojnë përgjegjësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm drejt një sistemi të pavarur të drejtësisë të cilat përputhen me standardet më të mira ndërkombëtare. Këshilli i Bashkimit Evropian zgjati mandatin e EULEX-it deri më 14 Qershor të vitit 2018, kjo pas përfun-

dimit të mandatit të parë që filloi në 2008 dhe përfundoi në 2016. Ky këshill ka aprovuar një buxhet prej 63.6 milion Euro për periudhën nga 15 Qershor 2016 deri më 14 Dhjetor 2016 për të gjitha veprimtaritë e saj në Kosovë dhe deri më 14 Qershor 2017 për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit specialist.

RISHIKIM I REKOMANDIMEVE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT TE KORRUPSIONIT NË KOSOVË, 2014

Rekomandim kryesor i Raportit të Vlerësimit të Korrupsionit në Kosovë nga SELDI 2014 ishte krijimi i një strategjie kombëtare kundër korrupsionit që është gjithëpërfshirëse dhe e përqendruar në vepra. Ishte rekomanduar që strategjia e re të rregulloj mangësitë e identifikuar në strategjitë kombëtare të mëhershme dhe të i kushtoj vëmendje të veçantë masave konkrete për anti-korrupsion. Në fakt, Kuvendi i Kosovës aprovoi Strategjinë e re Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit për periudhën 2013-2017, mirëpo dokumenti i ri vuan nga mangësitë e vjetra, dhe si rrjedhojë përfaqëson një udhëzues tjetër të turbullt kundër të gjitha çështjeve të lidhura me korrupsion. Shoqëria civile po ashtu ka kundërshtuar aprovimin e legjislacionit përkatës duke akuzuar se arritja më e madhe e strategjisë së re mund të jetë identifikimi i rasteve të vogla të rryshfetit. Ndërsa Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit nuk arrijnë të adresojnë nivelet më të larta të korrupsionit, procedurave të privatizimit, dhe çështjeve të prokurimit publik që paraqesin kërcënimin më të lartë për integritetin publik ²⁰.

Rekomandim tjetër nga studimi i parë ishte ndryshimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike në mënyrë që të definohet se si të bëhet auditimi i pasqyrave financiare nga partitë politike dhe se kush është përgjegjës për atë. Fatkeqësisht, kjo çështje pati ngecje në tri vitet e fundit pasi që përgjegjësia e auditimit të partive politike kaloi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion me pavarësi më të lartë, tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, brenda Kuvendit Kombëtar. Ky komision nuk arriti të publikoi auditimin e partive politike, duke krijuar kështu një situatë alarmuese.

Studimi 2014 po ashtu pati vërejtje ndaj Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë në Kosovë. U rekomandua që më shumë peshë të bie mbi subjektin e investigimeve. Sidoqoftë, ligji nuk ka pësuar ndryshime në këtë aspekt. Organizata Çohu rekomandon tutje që ky ligj të ri-dizajnohet për të bërë një trajtim më të gjerë të çështjes së konfiskimit të pasurive, dhe të përfshijë pjesë si procedura civile, identifikimi i instrumenteve ligjore për ngrirjen e statusit të pronës, marrjes dhe konfiskimit të saj ²¹.

20 Instituti Demokratik i Kosoves dhe Transparency International (2015), Vlerësimi i Integritetit Kombëtar. Prishtinë.

21 Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion, dhe Dinjitet, Cohu (2016), Konfiskimi i pasurise ne Kosove. Prishtinë.

Përmbyllja

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i hollësishëm i korrupsionit në Kosovë. Të dhënat e analizuar në studim i takojnë si natyrës primare ashtu asaj sekondare.

Në raport gjenden dy kapituj kryesor; kapitulli i parë prezanton metodologjinë empirike të përdorur dhe rezultatet e anketës së vitit 2016, ndërsa kapitulli i dytë sjellë një pasqyrë përfshirëse të mjedisit të korrupsionit. Seksioni i dytë prezanton një diskutim të zhvillimeve institucionale, juridike, dhe legjislativë të përfshira në misionin kundër korrupsionit në Kosovë.

Rezultatet e kapitullit të parë janë të ndara në tre seksione që trajtojnë aspekte të ndryshme të korrupsionit, duke përfshirë: (1) përvojën me korrupsionin, (2) qëndrimet ndaj tij dhe (3) vlerësimin e perceptimeve publike (mjedisi i korrupsionit).

Indekset e matura gjatë vlerësimit të Përvojës me korrupsionin janë Përfshirja e vërtetë në korrupsion dhe Presion të Korrupsionit. Vlerësimi i këtyre indekseve ka treguar se një pjesë e madhe e popullsisë është prekur nga korrupsioni; 27 për qind e popullsisë raportojnë se kanë përjetuar presionin e korrupsionit nga zyrtarët publikë dhe 22 për qind e popullatës kanë qenë të përfshirë në ndonjë lloj praktike të korrupsionit. Gjetjet më tej theksojnë se, në shumicën e rasteve, ryshfeti ndodh si rezultat i presionit të bërë nga zyrtarët e korruptuar publikë.

Qëndrimet ndaj korrupsionit shfaqin mundësinë e të anketuarve të përfshihen në korrupsion. Para së gjithash, vlerësimi i pranueshmërisë së korrupsionit tregon se gjysma e shoqërisë kosovare do të pranonte të përfshihet në një aktivitet të korruptuar në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, vetëdija e qytetarëve se çfarë përbën një sjellje të korruptuar është përmirësuar në krahasim me matjet e bëra në vitin 2014, edhe pse ato janë në nivel të ulët në krahasim me rajonin. Në mënyrë të ngjashme, indeksi i ndjeshmërisë së korrupsionit tregon se edhe pse përqindja e atyre që janë të gatshëm të përfshihen në korrupsion për të zgjidhur një problem të madh ka rënë nga 2014 në 2016, niveli është i ulët në krahasim me rajonin.

Së fundi, vlerësimi i mjedisit të korrupsionit ka konfirmuar edhe një herë seriozitetin e problemit të korrupsionit në Kosovë. Perceptimet e qytetarëve për presionin e korrupsionit janë të larta, pasi që 73 për qind e qytetarëve presin

të ballafaqohen me presionin e korrupsionit. Rezultatet gjithashtu tregojnë se problemi është përhapur në degët kryesore të qeverisjes, duke përfshirë Qeverinë, Parlamentin dhe gjykatat. Për më tepër, qytetarët janë përgjithësisht të dëshpëruar, gjë që dëshmohet me një përqindje në rritje të popullsisë e cila ka humbur besimin në mundësinë e reduktimit të ndjeshëm ose çrënjosjen e korrupsionit.

Diskutimi në kapitullin e dytë tregon se Kosova ka zhvilluar një kornizë ligjore mjaft të mirë kundër korrupsionit, edhe pse ende është në fazë të re të përputhjes me legjislativën e BE-së. Kosova ka themeluar agjenci, departamente të shërbimit dhe task-forca, suksesi i të cilave ka qenë i limituar. Për më tepër, Strategjia e re Kundër Korrupsionit dhe Plani për Veprim (2013-2017) nuk i ka arritur objektivat, dhe ka qenë e diskredituar nga shoqëria civile. Gjyqësori konsiderohet si i korruptuar dhe stafi i gjyqësorit si i politizuar. Transparenca në ndarjen e buxhetit, përdorimi i fondeve publike, dhe qasja në prokurim publik janë disa nga çështjet që duhet të përmirësohen sa më shpejtë.

Shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare kanë qenë të zëshme në adresimin e çështjeve të lidhura me korrupsion dhe kapje të shtetit. Sidoqoftë, edhe pas shtatë viteve në funksion të mbikëqyrjes së gjyqësorit në Kosovë me qëllim të luftimit të korrupsionit, EULEX ka arritur të ndjekë vetëm një numër të limituar të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Nga raporti i fundit të vlerësimit të korrupsionit nga SELDI (2014), nuk ka pasur mjaft progres në implementimin e legjislativës kundër korrupsionit dhe politikave të qeverisjes së mirë. Strategjia e re Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Plani për Veprim, edhe pse të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, hasin në zbatim të mangët. Amandamenti i Ligjit për Prokurim Publik ishte një zhvillim tjetër në periudhën e fundit, ndërsa prokurimit publik elektronik i përfshirë në këtë ligj filloi zbatimin në 2016.

Rekomandimet

Rekomandimi kryesor i cili rrjedh nga ky raport është nevojë urgjente për angazhimin me prioritet të luftës kundër korrupsionit nga të gjithë akterët relevantë. Nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse, e cila do të zbatohet dhe jo vetëm të hartohet për të përmbushur kërkesë për integritimin në BE, është me rëndësi të madhe.

Qytetarët duhet të raportojnë rastet kur janë detyruar të paguajnë ryshfet në baza më të shpeshta. Në të njëjtën mënyrë, ata duhet të zhvillojnë vetëdijen që duke qenë viktimë të korrupsionit, pra duke paguar ryshfet, gjithashtu edhe ata kontribuojnë për të keq në gjendjen tashmë të tmerrshme. Zhvillimi i një ndjenjë më të madhe të përgjegjësisë në mesin e qytetarëve mund të jetë një mjet efektiv për kundërvënien ndaj fenomenit.

Publiku i gjerë duhet të jetë këmbëngulës në kërkesën për një nivel më të lartë të përgjegjësisë dhe transparencës nga zyrtarët dhe institucionet qeveritare. Rritja e vetëdijesimit dhe ndjenjës së përgjegjësisë së qytetarëve do të mundësojë transformimin e këtyre në një faktor kyç në luftimin e korrupsionit.

Duhet punuar më tepër në zbatimin e sundimit të ligjit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Zbatimin e rregulloreve transparente në poste të larta të administratës, ku ekspozimi publik është i lartë, është me rëndësi jetike për reduktimin e korrupsionit.

Zyrës së Prokurorit të Shtetit duhet t'i jepet më shumë mbështetje gjyqësore nëpërmjet një ndryshimi në Ligjin kundër korrupsionit dhe duhet t'i shtohen burimet buxhetore dhe të personelit në përputhje me standardet e BE-së.

Kuvendi i Kosovës duhet të vlerësojë punën e Agjencisë kundër Korrupsionit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Duhet të ketë një bashkëpunim më të mirë mes AKK-së dhe institucioneve të tjera kundër korrupsionit si dhe shkëmbimi i informacionit duhet të jetë më efikas.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Avokatit të Popullit duhet të merren seriozisht nga Qeveria dhe thellojnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive të pavarura dhe Qeverisë.

Duhet të krijohet një mekanizëm për ndjekjen e progresit dhe mbledhjen e të dhënave në luftën kundër korrupsionit.

Dy rekomandimet e tjera, siç janë përmendur edhe në Raportin e fundit të vlerësimit të korrupsionit në shtet (nga SELDI), janë nevoja për Ligjin për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Paligjshme të ndryshohet për të adresuar barrën e çështjes së provës, si dhe rregullorja për mbrojtjen e "informuesit" duhet të sigurojë procedura të qarta, ose të paktën të ketë një organ të pavarur. Mbrojtja e informuesit është një çështje e ndjeshme që duhet të adresohet menjëherë jo vetëm për luftën kundër korrupsionit, por edhe për luftimin e krimit të organizuar.

Referencat

- Strategjia dhe Plani I Veprimit Kunder Korrupsionit (2013-2017). Retrieved from: http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_kunder_Korrupsionit_2013-2017.pdf
- Agjencia Kundet Korrupsionit (2015), Raporti Vjetor 2015.
- BIRN (2014), Monitorimi I Prokurimit Publik ne Kosove
- Komisioni Evropian (2016), Instrumenti per Asistence per Hyrje ne BE. Bruksel.
- Keshilli I Evropes (website). Buxheti I Kosoves <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2016/06/14-eulex-kosovo-budget/>.
- European Commission (2015), Kosovo Progress Report.
- European Commission (2014), Kosovo Progress Report.
- GAP (2016), Institucionet dhe agjencite e pavarura ne Kosove
- Gazeta Jeta ne Kosove. <http://kallxo.com/gjnk/zyra-e-kryeministrit-shmang-seancen-gjyqesore-ne-padine-e-birn-it-1/>.
- Gazeta Jeta ne Kosove (2015) Strategjia Kunder Korrupsionit pa efekt ne Praktike.
- Gazeta Express (2013), 'Shpartallohet grupi I prokuroreve'. Retrieved from: http://www.gazetaexpress.com/arkiva/shpartallohet-grupi-i-prokuror-235-ve-kund-235-r-korrupsionit-rezultati-zero-127612/?arch_tb=temp.
- Kallxo (2015) – Bie Nje pllake e tavanit ne pallat te drejtesise. <http://kallxo.com/bie-nje-pllake-e-tavanit-ne-pallat-te-drejtesise/>.
- Kallxo (2016) – Ashensoret e pallatit te drejtesise jashte funksionit. <http://kallxo.com/ashensoret-e-pallatit-te-drejtesise-jashte-funksionit/>.
- Kosova Democratic Institute (2016), Policy analysis on institutional mechanisms in the fight against corruption in Kosovo. Prishtina, Kosovo
- Kosova Democratic Institute (2015), Sistemi i Integritetit Kombetar. Prishtina, Kosovo.
- Kosova Democratic Institute (2016), Indeksi I Transparences ne Prokurim Publik.
- Kosovo Prosecutorial Council (2016), Performanca e prokuroreve
- Official Gazette of Republic of Kosovo - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>
- Website Zyrtar I Presidentit te Republikes se Kosves (2016) <http://www.president-ksgov.net/?page=1,132>
- Public Review Body (2016). Annual Report 2015
- Reuters (2014). Italian embassy staff implicated in Kosovo visa sales. <http://www.reuters.com/article/us-kosovo-italy-idUSBREA1610Y20140207>
- Reuters (2016). Six arrested, lawmaker sought, over alleged Kosovo land scam. <http://www.reuters.com/article/us-kosovo-crime-idUSKCN0X01UG>
- Riinvest Institute (2016), Budget transparency and Citizens Budget.
- Riinvest Institute (2014), Corruption and anti-corruption in Kosovo. SELDI
- Transparency International (2015), Corruption Perception Index. Retrieved from: <http://www.transparency.org/cpi2015>.
- UNDP (2015), Corruption-Risk Assessment in the Kosovo Education Sector.
- UNDP (2016), Public Pulse XI.
- UNDP/UNODC (2014). Judicial Integrity in Kosovo.
- UNODC (2013), Business, Corruption and Crime in Kosovo.

